

Врз основа на член 35 став 6 од Законот за занаетчиство (“Службен весник на Република Македонија” бр. 215/15), министерот за економија донесе

Нë базë тë nenit 35 paragrafit 6 тë Ligjit пëр Zejtari (Gazeta Zyrtare e RM” nr.215, ministri i ekonomisë solli

RREGULLORE

PËR PËRCAKTIMIN E VEPRIMTARIVE ZEJTARE, PËR KRYERJENE TË CILAVE NUK ËSHTË E NEVOJSHME ARSIMIM PROFESIONAL OSE AFTËSIM ADEKUAT PROFESIONAL

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohen veprimtaritë zejtare për kryerjen e të cilave nuk nevojitet arsimim profesional ose aftësim adekuat profesional

Neni 2

Veprimtaritë zejtare sipas Klasifikimit Nacional të Veprimtarive për kryerjen e të cilave nuk nevojitet arsimim adekuat ose aftësim adekuat profesional janë:

Numri rendor	Sektori	Klasa	Llojet e veprimtarisë zejtare
1.	A/A	01.49	Kujdesi për kafshë të tjera (mjaltëbërës, krimba)
2.	A/A	02.20	Shfrytëzimi i pyjeve (punues i qymyrit, prerës i drunjve
3.	A/A	02.30	Mbledhja e fry tave dhe produkteve të pyllit, përveç drunjve, mbledhës i frytave të pyllit
4.	A/A	02.40	Shërbime ndihmëse në pylltari (transport i trupave në pyje)
5.	B/B	08.11	Nxjerrja e gurit dekorativ dhe gurit për ndërtimtari, gëlqere, gips, shkums dhe shiste
6.	B/B	08.12	Nxjerrja e zhavorrit dhe rërës, argjilës dhe kaolinit
7.	B/B	10.39	Përpunim tjetër dhe konzervimi i pemëve dhe perimeve (qiqëra, faraxhi etj.)
8.	C/B	10.61	Prodhimi i produkteve të miellit (blues)
9.	C/B	10.83	Përpunimi i çajit dhe kafesë (blues i kafesë)
10.	C/B	13.10	Përgatitja dhe tjerja e fijeve të tekstilit
11.	C/B	13.30	Përfundimi plotësues i teksilit (zbardhje, ngjyrosja dhe shtypja)
12.	C/B	13.92	Prodhimi i produkteve të gatshme nga tekstili, përveç rrobave (jorganxhi)
13.	C/B	13.94	Prodhimi i litarëve, konopeve, gërshetave dhe rrjeteve (litarpunues)
14.	C/B	13.98	Prodhimi i tekstilit tjetër teknik dhe industrial
15.	C/B	14.19	Prodhimi i lëndëve dhe veglave tjera për rroba (thurës, kapelexhi)
16.	C/B	14.31	Prodhimi i çorapeve të thurura (thurës)
17.	C/B	14.39	Prodhimi i rrobave tjera të thurura (thurës)
18.	C/B	15.12	Prodhimi i valixheve, qeseve të dorës, dhe sendeve të ngjajshme, shalë dhe produkte të ngjajshme (samarxhi)
19.	C/B	15.20	Prodhimi i këpucëve (këpucar, opingaxhi..)
20.	C/B	16.10	Sharrimi dhe zdrukthimi i drunjve (sharrëtar)
21.	C/B	16.24	Prodhimi i ambalazhit prej druri (zdrukhtar)
22.	C/B	16.29	Prodhimi i produkteve tjera nga druri: prodhimi i sendeve nga kashta dhe

			materiali për thurje (shportar)
23.	C/B	23.32	Prodhimi i tjegullave, tullave dhe produkte nga argjila e pjekur për ndërtimtari
24.	C/B	23.41	Prodhimi i sendeve nga tjegulla për amvisëritë dhe sendeve dekorative nga tjegulla (poçar)
25.	C/B	23.52	Prodhimi i gurit gëlqeror dhe gipsit
26.	C/B	23.61	Prodhimi i produkteve nga betoni për qëllime ndërtimore
27.	C/B	23.70	Prerja, formësimi dhe përpunimi i gurit
28.	C/B	23.91	Prodhimi i produkteve gërryese (bluarje) (prodhimi i gurëve të mullirit)
29.	C/B	25.50	Farkëtimi, presimi, stampimi dhe dhe rrokullisja e metaleve; Metalurgjia e pluhurit (farkëtar, , mprehës)
30.	C/B	25.61	Përpunimi dhe veshja e metaleve (kallajxhi)
31.	C/B	30.99	Prodhimi i mjeteve të tjera të transportit të paspecifikuara të papërmendura në vend tjetër (karrocier, karrocier - farkëtar)
32.	C/B	32.91	Prodhimi i fshesave dhe brushave (fshesaxhi, brushtar)
33.	C/B	32.99	Prodhime të tjera, të papërmendura në vend tjetër (, lulishtar, lule, , kurora, sita, grilë, etj.)
34.	F/Ī	43.12	Punime përgatitore në kantier ndërtimi (gërmim, derdhje, nivelim i tokës, heqje gurësh)
35.	F/Ī	43.99	Punë të tjera të specializuara ndërtimore, të papërmendura në vend tjetër (roletar)
36.	G/E	45.20	Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve motorike (larës i veturave)
37.	N/JI	77.22	Marrja me qira e kasetave dhe disqeve (videotek)
38.	N/JI	81.21	Pastrimi themelor i ndërtesave (pastrues)
39.	N/JI	81.22	Veprimtaritë tjera të pastrimit të ndërtesave dhe objekteve (larës i dritareve, pastrues i oxhaqeve, kazaneve dhe shporeteve
40.	N/JI	82.19	Fotokopjimi, përgatitja e dokumenteve dhe veprimtarive të tjera të specializuara ndihmëse në zyrë (fotokopje)
41.	R/Ĥ	93.21	Veprimtaritë e parqeve argëtuese dhe tematike
42.	S/O	96.09	Veprimtari të tjera personale shërbyese, të papërmendura në vend tjetër

Neni 3

Me ditën e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje pushon vlefshmëria e Listës nr.4, Veprimtari Zejtari, për të cilat nuk nevojitet arsimim adekuat nga Rregullorja e përcaktimit të veprimtarive që mund të kryejnë zejtarët (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.87/04, 14/08 и 44/09).

Neni 4

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e nesërme nga dita e publikimit në “Gazetën Zyrtare të RMV”.

nr. _____

_____ 2022

Shkup

Ministri i Ekonomisë,
Kreshnik Bekteshi, n.p

